

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE**

Nr. prot. _____

Tiranë ___/___/ 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

OPERATORIT EKONOMIK “LIGUS” SHPK

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **Proçedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - mallra.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13450-07-17-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje Karrotrec për Policinë Bashkiake”.**

Kohëzgjatja e kontratës: Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditë pune. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mjeteve, brenda këtyre afateve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [22.07.2024] [Nr.40].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “LIGUS” SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

NIPT L51523001S

Numri i NIPT-t

Vlera 67,800,000 [gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind mijë] lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. Operatori ekonomik “SPARKLE 32” SHPK

NIPT L51327014R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 69.000.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “SPARKLE 32” SHPK

NIPT L51327014R

Për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1) d. “Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2” referuar Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së, pasi lista e cmimeve dorëzuar nga operatori nuk është dorëzuar në formatin e publikuar në DST. Referuar edhe vendimin të KPP-së Nr. 666/2021 ku për të njëjtin rast është marrë vendimi si me poshtë:

“Sa më sipër KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “x” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.”

Gjithashtu, referuar DST-së, Udhëzime për Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, nënpika 9/1 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës, citohet shprehimisht: **1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.**

2. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën **2.2.1** të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”* Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, me Nr. T11162495, datë 06.08.2024, nga ku rezulton se nuk plotëson vlerën e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar e cila duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet, përkatësisht 70.000.000 lekë.
3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.4.2** të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B, sipas Udhëzimit Nr. 1546 datë 29.03.2016, “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj.”* Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kriterit të mësipërm, si rrjedhim KVO është përpara faktit që nuk mund të bëjë gjykoj/vlerësoj përse i përket kapacitetit teknik të operatorit ekonomik.
4. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën **2.4.3** të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ Distributorit të Autorizuar si telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për mjetet e ofruara”. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur katalogun dhe autorizimin përkatës të mjetit “**Kamion Karrotrec Pirun**”, ndërkohë që mungon katalogu dhe autorizimi nga prodhuesi/distributori për “**Të dhënat e platformës ngritëse**”, sipas përcaktimeve të vendosura edhe në specifikimet teknike pjesë përbërëse e DST-ve.*

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik **“Sparkle 32” sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**Operatori ekonomik “LIGUS” SHPK** me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 67,800,000 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Zëvendëskryetar / Person i autorizuar